

EKSTRAKT NGA INTERVISTA

[Intervista e gjatë e historisë gojore me narratoren u realizua më 22 maj, 2021 në Prishtinë. Me kërkesen e narratores për anonimitet, ne kemi fshehur identitetin.]

Intervistuesja: Kallxom, sa fëmijë i ki?

Narratorja: Katër.

Intervistuesja: Kur e ki lindë fëminë e parë?

Narratorja: Fëminë e parë, besa tash djali i madh qe 46 vjet i ka bo qetash me 1 prill.

Intervistuesja: E ke lindë me 17-18 vjet?

Narratorja: Po qashtu i kom pasë. Beso në shpi e kom lindë, fëminë e parë në atë kohë, po.

Intervistuesja: Hajt kallxom pak, qysh?

Narratorja: E kom lindë në shpi, isha shtatzone, nejse erdha te mjeku, u kontrollojsha thotë, “Ki kohë” a din, “Ki kohë”. Kur shkoj në spital, po thotë mjeku, “Hajt” thotë, “bon me nejt nja tri-katër ditë nashti lindë se masi koke prej fshatit” thotë, a din, “mos m’u maltretu, po të nalim për ni javë po kqyrum a e ki kohën me lindë”. Um nalën u bo ni javë, “Vallahin” thotë, “s’e ki kohën”. Apet um lëshojnë, shkoj te shpia. Mas ni jave Zoti, e linda djalin e parë, fëminë. Në shpi.

Intervistuesja: Qysh?

Narratorja: Më kapën dhimtë. Ish qishtu kah mesdita, kem t’u hongër drekë. Ish motra e burrit, vetëm qat motër e kanë pasë, ajo osht’ vdekë. Edhe thotë, se motër i thojshin se veç njo të hasretit e kanë pasë e dy vllazën. Thotë, “Moj motër” thotë, “po du me shku te shpija qe dy javë jom ardhë” thotë, “në pushim e vallahin” thotë, “ti s’linde” thotë, “kisha pasë qef me qëllu” a din, “edhe të kisha ndihmu”. Zoti, tu i bo ato fjalë, tu hongër drekë, veç ma kanë ngjitë dhimtë, në momentin. E jom çu më ka ardhë

marre ish vjehrri, ai mashkull. Jom çu jom dalë jashtë, thotë vjehrra, “Çka u bo?” Thom, “Jom smutë”. Nuk disha për fëmi të parë qysh të kapin dhimtë, veç e pashë që u koçita në midis hajt, hajt. Ata e kryjtën çpejtë bukën, dolën. Une u ensha, u ensha oborrit, si më kapshin dhimtë unë u kapsha për ni pemë edhe pushojsha apet, apet. 15 ora në pesë e kom lindë fëminë. Hijmë mrena...

Intervistuesja: Qysh, qysh edhe niherë?

Narratorja: 15 ora të mramjes, 15 në pesë [16:45] e kom lindë djalin. Prej orës, qaty dikun dy orë kum pasë dhimtë, masdite. Hijmë mrenda edhe thotë vjehrra, qetu më dhimke shumë a din, përmiti ajo e ngrata m’i majke dy gujt thojkë, “Nashti pak” a dinë “qetësohen dhimtë”. E tu ardhë dhimtë, tu ardhë koha për me lindë, tu e lut Zotin, tu e lut Zotin. Ajo kunata ish përpara ajo më ndihmojke si mjeke, veç thojke, “Jepi zor, merr frymë thellë, merr frymë thellë” edhe linda djalë, fëminë e parë në shpi.

E ka marrë, ja ka pre kthizën vet kunata. E ka rahatu ma së pari djalin tani kadal-dalë unë s’disha çka ndodh mas, thojke, “Motër e ki edhe ni vështirësi”, “Po çka kom?” Tha, “Ki me qit [jashtë] onin [qeska amniotike] e fëmisë”. Edhe tha, “Fryj” a din këto kënatat e dheut jonë konë përpara të ujit. “Fryj” tha, “qasaj shumë edhe oni [qeska] del”. I fryva tri herë edhe u shlirova. Edhe ajo ish problem se, “M’u bo m’u ajë” tha, “munesh me vdekë”. Edhe Zoti um shliroi me të mirë, um pastroi. (qesh) Rashë me djalë në shtrat edhe sot e atë ditë kurrfarë problemi s’kom pasë kurrë.